



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE INF.SJP-A
SEKTORI JURIDIK

Nr. 869 Prot

Tiranë, më 02.07.2024

URDHËR

Nr. 92, datë 02.07.2024

**PËR KRYERJEN E LEJES VJETORE TË VITIT 2024 PËR PERSONELIN
ADMINISTRATIV, PËR PERSONELIN AKADEMIK DHE ATË
NDIHMËSAKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Mbështetur në nenin 92 dhe 93 të ligjit nr. 7961, datë 12.07. 1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë“ i ndryshuar, në nenin 39, pika 5 të ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 10 të Vendimit nr. 329, datë 12.04.2017 të Këshillit të Ministrave “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 220, datë 24.05.1994 “Për pushimin plotësues në sektorin e arsimit” si dhe në Statutin e Universitetit të Arteve, pas diskutimeve me Dekanatet e Fakulteteve dhe me Rektoratin e UART, në cilësinë e titullarit të institucionit,

URDHËROJ:

1. Personeli administrativ dhe ndihmësakademik i Universitetit të Arteve, të fillojë lejen vjetore për vitin 2024:

- **Nga data 15 Korrik 2024 deri më 12 Gusht 2024;**

Data e paraqitjes në punë për personelin administrativ dhe ndihmësakademik është **12 Gusht 2024;**

- **Anëtarët e personelit administrativ dhe ndihmësakademik, që për arsye pune ndërpresin lejen vjetore me urdhër të titullarit, do ta vijojnë lejen vjetore sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.**

2. Personeli akademik i Universitetit të Arteve, të fillojë lejen vjetore për vitin 2024:

- **Nga data 8 Korrik 2024 deri më 19 Gusht 2024;**

Data e paraqitjes në punë për personelin akademik është **19 Gusht 2024;**

- **Anëtarët e personelit akademik, që për arsye pune ndërpresin lejen vjetore me urdhër të titullarit të institucionit, do ta vijojnë lejen vjetore sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.**

3. Personeli akademik, deri më datë 8 Korrik (që përkon me ditën e parë të fillimit të lejes), duhet të ketë plotësuar këto detyrime: provime, procesverbale, evidenca të ngarkesave mësimore dhe çdo dokumentacion tjetër të detyrueshëm për t'u plotësuar dhe për t'u dorëzuar në strukturat përkatëse apo çdo detyrim tjetër që mund të ketë në njësinë përkatëse apo në institucion.

4. Ditët e mbetura nga leja vjetore e paguar e vitit 2024, do të jepen, sipas rastit, në ditët e pushimeve të fundvitit, por jo më vonë se përfundimi i semestrit të parë të vitit akademik 2024-2025.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria Ekonomike dhe Investimeve, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Inf.SJP-A dhe Fakultetet e UART.

6. Ky urdhër të publikohet në faqen elektronike të UART.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


REKTORI
Prof. Kastriot ÇAUSHI